

VENDIM
Nr. 117, datë 8.10.2013

**PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE TË PËRZGJEDHJES DHE EMËRIMIT TË
ADMINISTRATORIT TË PËRKOHSHËM TË SHOQËRISË “CEZ SHPËRNDARJE”**

Në mbështetje të neneve 8, 9 dhe 18 pika 4 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, vendimit të Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 4, datë 21 janar 2013 “Për heqjen e licencave të shoqërisë “CEZ Shpërndarje” sh.a., për aktivitetin e shpërndarjes së energjisë elektrike, miratuar me vendimin nr. 8, datë 25.1.2008, të ndryshuar, dhe për aktivitetin e furnizimit publik me pakicë të energjisë elektrike”, të miratuar me vendimet e Bordit të Komisionerëve nr. 9, datë 25.1.2008, të ndryshuar”, vendimit nr. 5, datë 21.1.2013 të Bordit të Komisionerëve të ERE-s “Për vendosjen e shoqërisë “CEZ shpërndarje” sh.a., në administrim të përkohshëm dhe emërimin e administratorit të shoqërisë “CEZ Shpërndarje” sh.a.”, në zbatim të vendimit të Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 4, datë 21 janar 2013 “Për heqjen e licencave për aktivitetin e shpërndarjes të energjisë elektrike dhe aktivitetit të furnizimit publik me pakicë të energjisë elektrike të shoqërisë “CEZ Shpërndarje” sh.a.”, neni 4 i rregullores “Mbi procedurat e emërimit të administratorit dhe kompetencat e tij”, miratuar me vendimin nr. 1, datë 10.1.2013, Bordi i Komisionerëve i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 8.10.2013, pasi shqyrtoi kërkesën e administratorit aktual të përkohshëm të shoqërisë “CEZ Shpërndarje” për lirim nga detyra dhe relacionin e drejtorive teknike të ERE-s,

VENDOSI:

1. Të pranojë dorëheqjen e paraqitur nga ana e administratorit aktual të shoqërisë, z. Sahit Dollapi, i cili do të vijojë ushtrimin e detyrës deri në momentin e përzgjedhjes së administratorit të ri të shoqërisë “CEZ Shpërndarje” nga ana e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.
2. Fillimin e procedurave të përzgjedhjes së administratorit të përkohshëm të shoqërisë “CEZ Shpërndarje”.
3. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të përgatisë të gjitha procedurat në lidhje me zbatimin e këtij vendimi të Bordit të Komisionerëve të ERE-s.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-s
Petrit Ahmeti